

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Sistemim Asfaltim i Rruges se Malesoreve,”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45000000-7, punë ndërtimi

VLERA E FONDIT LIMIT: 6.378.295 (gjashte milion e treqind e shtatedhete e tete mije e dyqind e nentdhete e pese) lek pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Vau Dejës** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të Nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP “1. *Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik*”.

Neni 83 i LPP “*Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël*”,

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe si dhe ne Ligjin Nr.9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, të ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022-2023-2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera së përlllogaritur të kontratës që prokurohet.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 3 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, “*Ne lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë që operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën*”, “*Xhiroja vjetore minimale që kërkohej nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*”, si dhe bazuar në nenin 43, pika 2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) *vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar*

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të kësaj procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohe dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe vendosja e këtij limiti nuk kufizon pjesëmarrjen e operatoreve ekonomike.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.” pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin të dorëzojnë në administratën tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës bilancin kontabël së bashku me anekset e tij, si dhe Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022 -2023 dhe 2024, të certifikuara nga autoritetet përkatese (Dega e Tatim Taksave) ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitet për vitin 2025 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2025.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 43, nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

Meqenese operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrorjnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: **3.189.147** (tre milion e njeqind e tetedhjetë e nente mijë e njeqind e dyzet e shtatë) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: **12.756.590** (dymbëdhjetë milion e shtatëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e nentëdhjetë) lekë pa TVSH.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve të sipërpermendura të oferten të kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i perfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudit;(nese leshohet)
 - Çertifikaten e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim.
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i perfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
 - Kontrate Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudit;(nese leshohet)
 - Çertifikaten e marrjes në dorezim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim;
 - Fatura tatimore perkatese.

Argumentimi: Përvoja e suksesshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: **3.189.147** (tre milion e njëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e dyzet e shtatë) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: **12.756.590** (dymbëdhjetë milion e shtatëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë) lekë pa TVSH.

Pika 1/a plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

Gjithashtu referuar VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, Kreu XI, Neni 88, pika 3 citohet se: *”Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”* AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave (1.2-1.4), të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” ku qartazi përcaktohet se: *”Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”, si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: *”Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”*

AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave 1.3 dhe 1.4, të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të

kontratës objekt prokurimi. Sqarojmë se nga praktika, gjatë fazes së vlerësimit të ofertave, AK ka hasur vështirësi në vlerësimin në mënyrë sa më të drejtë të përvojës së ngjashme, pasi jo të gjitha institucionet shtetërore apo private leshojnë Formularin e Vlerësimit sipas formatit zyrtar (ku përcaktohet ndarja e përqindjeve). Në kuadër të vlerësimit të ofertave në mënyrë sa më të drejtë, duhet që në rastet e BOE apo Nenkontraktim, vlerësimi i përvojës të vërtetohet me paraqitjen e kontratës së bashkëpunimit; me marrëveshjen e nenkontraktimit si dhe me aktin e miratimit të nenkontraktimit leshuar nga Institucioni. Ky dokumentacion disponohet nga çdo OE si në rastin kur ka qene pale në Bashkimin e OE ashtu dhe në rastet kur ka qene Nënkontraktor. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që duhet ta ketë çdo kompani në dosjen e saj, për rrjedhojë nuk mund të sjellë kufizim të pjesëmarrjes së OE në tender as në mënyrë direkte dhe as në mënyrë indirekte.

Gjykojmë që kërkesa e mësipërme nuk është në kundërshtim me asnjë nga dispozitat ligjore që parashikon legjislacioni i prokurimit publik.

Gjithashtu vendos në kushte të barabarta dhe u jep mundësi të gjithë OE ofertues edhe në ato rastet kur Formularët e Vlerësimit mund të jenë të paplotesuara sipas standartit.

AK ka kërkuar këto dokumenta në përputhje me parashikimet e Nenit 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ku ndër të tjera përcaktohet se: ***”Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”***

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me licencë profesionale sipas modelit të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ose ekuivalente për operatore të huaja cila të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

Punime të përgjithshme ndërtimi:

Kategoria NP-1 Niveli A “Punime germimi”

Kategoria NP-4 Niveli A “Rruge ,autostrada,mbikalime”

Punime speciale ndërtimi:

Kategoria NS-7 Niveli A “Barriera dhe mbrojtje rrugore”

Kategoria NS-18 Niveli A “Punime topogjeodezike”

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.01.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", i ndryshuar.

Përcaktimi i kategorisë së licencave bazohet në kriteret të përcaktuara ligjore e teknike. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton

"Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore, perkatesisht si me poshte;

“N.P. 1 Punime gjurmimi në tokë

Konsiderohen **gjurmimet**, sistemimet dhe **ndryshimet në volum** të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjurmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorishte ose shkëmbore.

N.P. 4 Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvai, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar **rrugët**, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet në nivele dhe në lartësi, parkimet, punime të **mureve mbajtëse**, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tranvai, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, **sheshet** të realizuara me materiale të veçanta, natyrore dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, **betonarme të thjeshtë** dhe të parandëruar, parafabrikat ose të prodhuar në objekt.

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndjerë paqëndrueshmërinë mbi “goma”, “hekur”, “zona”, kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore

N.S – 7 Barriera dhe mbrojtje rrugore

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja ristrukturimi i elementeve si **guard rail**, në jersey, zvogëuesit e zhurmave, **barrierat** në kthesa dhe të ngjashme, të realizuar për të siguruar fluksin e mjeteve rrugore dhe për të mbrojtur rënien në kthesa.

Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane. Lidhur me nivelin e kategorive në licencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomik të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko profesionale në nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Licencat janë të lidhura ngushtësisht me zerrat e punimeve të ndërtimit. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti i vlerëson të nevojshme, për sa kohë ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
<u>Kategoria NP-1</u>	Punime germimi	Shuma 1,2 e preventivit	Niveli A	295 224.66
<u>Kategoria NP-4</u>	Rruge ,autostrada,mbikalime	Shuma 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9 (An2) e preventivit	Niveli A	5 125 843.05
<u>Kategoria NS-7</u>	“Barriera dhe mbrojtje rrugore”	Shuma 9 (An1) e preventivit	Niveli A	1 199 753.83
<u>Kategoria NS-18</u>	Punime topogjeodezike		Niveli A	

Shenim: Pika e licences për punime topogjeodezike është kërkuar për shkak se kemi të bëjmë me infrastrukturë rrugore dhe projekti parashikon përmirësim të gjeometrisë horizontale dhe vertikale të rrugës. Piketimi dhe kontrolli topografik duhet bërë në çdo fazë të zbatimit të punimeve.

2.3.3 Vetdeklarimin nga inxhinierat se ata janë të disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në Rekomandimin Nr. 6732 datë 21.10.2020 “Mbi Problematikat e konstatuara gjatë monitorimit nga APP”.

22.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për realizimin dhe zbatimin e kontratës. Për kryerjen e punimeve numri i punonjësve pa përfshirë stafin inxhinierik duhet të jetë **minimalisht 14 (katërmbëdhjetë) punonjës të cilët duhet të figurojnë në listëpagesat e të paktën** muajit të fundit, sipas kërkesave specifike për çdo punonjës si më poshtë :

2.3.4.a) Stafi inxhinierik

a) 1 (një) inxhinier ndërtimi - drejtues teknik

Inxhinieri i ndërtimit duhet të jetë i pajisur me diplomë dhe duhet të figurojë si drejtues teknik në licencën e shoqërisë si dhe të disponojë kontratë pune të vlefshme.

Drejtuesi teknik duhet të paraqesë një deklaratë ku garanton se është i disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate.

b) 1 (nje) inxhinier topograf

Inxhinieri topograf duhet të jete i pajisur me licence profesionale dhe kontrate pune të vlefshme.

Inxhinieri topograf duhet të paraqesë një deklaratë ku garanton se është i disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate.

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës,që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratën sipas preventivit dhe grafikut të punimeve (pjesë e dosjes të projekt zbatimi punuar nga “ANGERBA” shpk).

2.3.4.b) Stafi i punetoreve të specializuar

a) 3 (tre) Manovratorë

Manovratorët (drejtuesit e makinerive të rënda eksavatorit/ fadromës, makinave ngjësëse dhe të asfaltimit) duhet të jenë punonjës të specializuar për drejtimin e mjeteve të rënda dhe për këtë duhet të paraqesin deshmi nga Drejtoria e Sherbimit të Transportit Rrugor, deshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente. (Në rastin kur punonjësit Manovrator janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

b) 2 (dy) shoferë kamioni

Shoferët e kamionit duhet të jenë punonjës të specializuar për drejtimin e mjeteve të rënda dhe për këtë duhet të paraqesin deshmi nga Drejtoria e Sherbimit të Transportit Rrugor, deshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente. (Në rastin kur këto punonjës janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

c) 2 (dy) Betonues dhe të tjerë që lidhen me to

d) 2 (dy) punetore asfalti

e) 2(dy) Muratorë dhe të tjerë të ngjashëm

Nga ana teknike argumentojmë se numri mesatar i punonjësve është caktuar në bazë të llogaritjeve të zërave të punës dhe volumit përkatës të çdo zëri në preventiv si dhe grafikut në zbatimin të punimeve, të cilat duhet të përfundojnë brenda 2 muajve kalendarikë nga data e nënshkrimit të kontratës, mbështetur kjo në VKM Nr. 216 datë 13.04.2023 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

- Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese vertetim të lëshuar nga Dega e Tatim Taksave ose Dega e Sigurimeve Shoqerore dhe Shëndetsore në të cilin të jetë i percaktuar numri i punonjesve të siguruar për periudhën e mësipërme, shoqëruar me listepagesën perkatese E-Sig, për kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shëndetsore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” në nenin 39, pika 6, gërma c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe ligjin 8402 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” datë 10.09.1998 i ndryshuar.

Është kërkuar inxhinier ndërtimi për zbatimin e punimeve në përputhje me zerat e punimeve të preventivit, projektit, specifikimeve teknike që do të zbatohen dhe si dhe kategorive perkatese në licencën perkatese të zbatimit. **Inxhinieri ndërtimit-drejtues teknik** është përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi.

Është kërkuar **inxhinier topograf** për kryerjen e punimeve topografike për nxjerrjen e kuotave të punimeve të germimit si dhe kuotat e shtresave rrugore, sistemimin e kanaleve anësore etj.

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe 39, pika 6, gërma Ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Kërkesa që punonjësit të jenë me deshmë kualifikimi të sigurimit teknik (te vlefshme) të lëshuara nga organizma të akredituar për këtë qëllim në Republikën e Shqipërisë është bërë bazuar duke vlerësuar se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin deshmë për sigurimin e jetës dhe shëndetit të punëmarrësve nëpërmjet zbatimit të masave të nevojshme.

Kërkesa për deshmitë e drejtuesve të mjeteve të rënda bazohet në Urdhërin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 200, datë 16.5.2019 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe 39, pika 6, gërma Ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Vendosja e ketyre kriterëve për fuqinë punëtore është bërë në përputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve që është perlllogaritur si dhe mjeteve të kërkuara për zbatimin me sukses të kesaj kontrate.

Në lidhje me vërtetimin të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve kjo kërkesë është e mbështetur në Nenin 39, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” sipas së cilës: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriterë të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurrohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Kategorizimi i profesionit të punonjësve është bërë bazuar në kodet e përcaktuara në VKM 514 datë 15.09.2017, si më poshtë:

7112 “Muratorë dhe të tjerë të ngjashëm” Kodi i profesionit: 7112

Përshkrim i përgjithshëm i grupit të profesioneve “Muratorë dhe të tjerë të ngjashëm”, niveli i dytë i kompetencës në LKP. Muratori dhe të tjerë të ngjashëm ndërton dhe riparon themele, mure ndarëse, oxhaqe, harqe, mure të puseve (për veshjet e tyre me gurë), rrugë dhe **kalldrëme prej guri** dhe struktura të tjera të ndërtimi, me llaç, tulla, gurë, blloqe betoni dhe materiale të ngjashme. Muratori ndërton, riparon mure dhe tavane; i bën ato me gips, tavane të varura zbukurues, sipërfaqe të tjera dekorative etj. Ai/ajo mund të punësohet në kompani të ndryshme me aktivitet ndërtimi, shërbimi etj., apo të vetëpunësohet. **Funksionet kryesore:**

Muratorë dhe të tjerë të ngjashëm kryejnë një pjesë ose tërësinë e funksioneve të mëposhtme, sipas mënyrës së organizimit të punës: a) Njihen me projektin dhe specifikimet teknike të punës që do të kryejnë; b) Njihen me objektin e punës; c) Konsultohen me kolegët e tjerë të punës për procesin e punës; d) Bëjnë rikonicionin paraprak të vendit të punës para fillimit të procesit; e) Bëjnë organizimin e punës; f) Përzgjedhin materialet e nevojshme dhe veglat e punës para fillimit të procesit të punës; g) Respektojnë me rigorozitet radhën e kryerjes së çdo procesi pune sipas orientimit të dhënë në objekt; h) Respektojnë rregulloren e brendshme të përcaktuar më parë nga drejtuesi i punimeve në objekt; i) Bëjnë piktimin e mureve të objektit (si p.sh: të furrave për djegie, të oxhaqeve, të puseve për veshje e tyre me gurë, të rrugëve dhe kalldrëmeve prej guri; apo të konstruksioneve të tjera në ndërtim); j) Bëjnë përgatitjen e sasisë së nevojshme të llacit për procesin ditor të punës, duke respektuar porcionet e duhura të materialeve përbërëse; k) Bëjnë breza përforcues betoni në gjysmën e lartësisë së murit ose sipas specifikimit në projekt; l) Kontrollon nëse muret janë të lidhur midis tyre horizontalisht dhe vertikalisht duke garantuar kështu qëndrueshmërinë e tyre; m) Ndërtojnë soletat; n) Vendosin arkitrarët e dyerve dhe dritareve; o) Vendosin kondrakasat e dyerve dhe dritareve, nëse ka të tilla të parashikuara në projekt; p) Bëjnë mbushjen me llac të mureve në nivelin e fashëve me dorë ose me pompë në varësi të materialit të përcaktuar nga drejtuesi teknik në objekt; q) Përgatitin materialin e nevojshëm për tavane me gips apo për tavane të varura zbukurues duke bërë matjet dhe prerjet e duhura; r) Bëjnë stukime apo riparimet e duhura të objekteve të ndryshme; s) Bëjnë kontrollin përfundimtar të punimeve, duke u siguruar që gjithçka është sipas përshkrimit në projekt; t) Zbaton rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit; u) Bëjnë preventive për shërbimet e ndryshme që realizohen në njësinë e biznesit.

7114 Betonues dhe të tjerë që lidhen me to : Kodi i profesionit: 7114 Përshkrim i përgjithshëm i grupit të profesioneve “Betonues dhe të tjerë që lidhen me to”, niveli i dytë i kompetencës në LKP.

Betonuesi dhe të tjerë që lidhet me to ndërton korniza dhe struktura të përforcuara prej betoni ose prej allçie, përforcojnë sipërfaqet e çimentos, bën vendosjen e çimentos në mure, korniza shkallësh, tarraca, etj. Gjithashtu, ai përfundon dhe riparon sipërfaqe prej çimentoje. Ndërton struktura të përforcuara hekuri për vëllimet apo sipërfaqet që do të betononjë sipas një projekti paraprak. Ai mund të punësohet në kompani të ndryshme me aktivitet ndërtimi apo të vetëpunësohet. Funksionet kryesore: Betonuesit dhe të tjerë që lidhet me to kryejnë një pjesë ose tërësinë e funksioneve të mëposhtme, sipas mënyrës së organizimit të punës: “a) Njihen me projektin dhe specifikimet teknike të objektit ku do të punojnë; b) Bëjnë kontrollin paraprak të vendit të punës para fillimit të procesit; c) Bëjnë organizimin e punës me kolegët e tjerë përpara fillimit të procesit; d) Bëjnë sistemimin e materialeve dhe veglave të punës sipas proceseve të punës. e) Respektojnë me rigorozitet radhën e kryerjes së çdo procesi pune sipas orientimit të dhënë në objekt; f) Sigurojnë sasinë e duhura të materialeve për betonin (hekur, dërrasa, skela, zhavorr, çimento, rërë, ujë etj.), sipas markave të përcaktuara në projekt; g) Realizojnë – në bashkëpunim me punëtorët e tjerë – ndërtimin e skelës që do shërbejë si plan pune për zhvillimin e operacionit; h) Ndihmon në ndërtimin e armaturës brenda së cilës do derdhet betoni, vendosjen e kallëpeve apo formave të ndryshme sipas projekteve paraprake; i) Vendosin shtyllat mbajtëse të peshës, morsetat dhe mjetet e tjera që sigurojnë qëndrueshmërinë e armaturës ndaj peshës dhe presionit të ngarkesës beton; j) Ndihmojnë në vendosjen e hekurit të duhur dhe lidhjen e tij; në sasinë dhe formën e përcaktuar në projektin inxhinierik; k) Realizojnë procesin e përzierjes së sasisë së duhur dhe raportet e paracaktuara të materialeve përbërëse të betonit me sasinë e duhur të ujit, me dorë ose me makineri; l) Shpërndajnë betonin dhe e shtrojnë atë në soleta, kolona, shkallë, mure, ballkone, ura, apo strukturave të tjera në kohën e duhur, sipas radhës së përcaktuar nga projekti dhe drejtuesi teknik i objektit; m) Bëjnë vibrimin e betonit gjatë çdo betonimi; n) Kryejnë nivelimin e betonit;¹³ o) Kryejnë lustrimin e betonit apo çimentos; p) Bëjnë trajtimin me ujë të strukturave pas betonimit; q) Bëjnë riparimin e defekteve të vogla pas betonimeve (zgavra, vrima etj.); r) Bëjnë dorëzimin e punimeve tek drejtuesi teknik i objektit duke bërë dhe shënimet përkatëse të afateve të punimit të kryer; s) Bëjnë riparime të ndryshme të sipërfaqeve të betonuara; t) Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit. u) Bëjnë preventiv për shërbimet e ndryshme që realizohen në njësinë e biznesit”

7119.15 Punëtor asfaltimi në rrugë (Grup njësi - Punëtorë ndërtimi të paklasifikuar diku tjetër) y) Kryejnë asfaltim apo punime mirëmbajtje në rrugë;

Kërkesat për punësim: a. Zakonisht kërkohet përfundimi i një kualifikimi profesional për këtë profesion. b. Të jetë e/i aftë fizikisht dhe mendërisht.

Manovratorët (drejtuesit e makinerive të rënda eksavatorit/ fadromës, makinave ngjeshëse dhe të asfaltimit) dhe shoferat e kamionit (Grupi-njësi (Profesioni) “Shoferë të makinave të rënda dhe kamionëve” Kodi i profesionit: 8332)

8332.03 Drejtues të makinave të asfaltimit

8332.06 Drejtues të makinave të ngjeshjes (rrula)

8332.14 Shofer kamioni

Kërkesat për punësim a. Të jetë e/i pajisur me leje drejtimi të nivelit përkatës. b. Zakonisht kërkohet përfundimi i një shkolle profesionale në këtë fushë. c. Të ketë kryer një kurs formimi profesional për këtë profesion. d. Të jetë e/i aftë fizikisht dhe mendërisht.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlogaritur për cdo zë punimesh, bazuar në afatin përkatës të grafikut të punimeve si më poshtë:

3.2	Prerje bime te vogla ø ~ 10cm	m2	190.0	5								
	Punetori e thjeshte (paga bruto +kontributet)	op		15.20				1.90	5	0.38		
3.4	Preje e sistemim pemesh ø 21 ~ 40 cm	cope	6.0	11								
	Punetori e thjeshte (paga bruto +kontributet)	op		7.20				0.90	5	0.18		1
3.89/b	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet	m3	453.0									
	Ekskavator 0.25 m3	op				45.30		5.66	5	1.13		1
3.158/4a	Transport dheu me auto deri 4.0 km	m3	453.0									
	Transport me auto vetshkarkuese 4 km	op			3,261.60			407.70	5	81.54		1
3.183/a	Shtrese zhavor lumi t=10cm	m3	123.0	5								
	Sp+p	op		15.99				2.00	5	0.40		
	Zhavor lumi	m3					13.53	1.69				
	Grejder	op				2.46		0.31				
3.183/a	Shtrese zhavor lumi t=10cm	m3	104.0	15								
	Sp+p	op		13.52				1.69	15	0.11		
	Zhavor lumi	m3					11.44	1.43				
	Grejder	op				2.08		0.26	15	0.017333		
3.237	Struktura monolite b/betoni C 12/15 me 25% gur	m3	82.0	20								
	Sp+p	op		885.60				110.70	20	5.54		
	Betonjere 500 liter	op				25.42		3.18	20	0.16		
	Vibrator thellesie	op				53.30		6.66	20	0.33		
	Cimento 32.5 N	kg					14,104.0					
	Zall (granil) lavatrice	m3					50.0					
	Rere e lare lavatrice	m3					29.5					
	Gure kave	m3					30.3					
	Kallep themele e mure me derrasa te veçuara	m2					237.8					
	Uje teknologjik	l					16,400.0					
3.243/1	Struktura te holla monolite betoni C 16/20	m3	13.0	20								
	Sp+p	op		166.40				20.80	20.00	1.04		
	Vibrator thellesie	op				21.32		2.67	20.00	0.13		
	Betonjere 500 liter	op				8.45		1.06	20.00	0.05		
	Cimento 32.5 N	kg					3,770.00					
	Rere e lare lavatrice	m3					6.11					

	Kallep themele e mure me derrasa te veçuara	m2					70.20					
	Uje teknologjik	l					2,600.00					
	Zall (granil) lavatrice	m3					9.75					
3.243/1	Struktura te holla monolite betoni C 16/20	m3	22.0	20								
	Sp+p	op		281.60				35.20	20.00	1.76		
	Vibrator thellesie	op				36.08		4.51	20.00	0.23		
	Betonjere 500 liter	op				14.30		1.79	20.00	0.09		
	Cimento 32.5 N	kg					6,380.00					
	Rere e lare lavatrice	m3					10.34					
	Kallep themele e mure me derrasa te veçuara	m2					118.80					
	Uje teknologjik	l					4,400.00					
	Zall (granil) lavatrice	m3					16.50					
3.243	Struktura monolite betoni C 16/20	m3	22.0	15								
	Sp+p	op		281.60				35.20	15.00	2.35		
	Vibrator thellesie	op				36.08		4.51	15.00	0.30		
	Betonjere 500 liter	op				14.30		1.79	15.00	0.12		
	Cimento 32.5 N	kg					6,028.00					
	Rere e lare lavatrice	m3					10.12					
	Kallep themele e mure me derrasa te veçuara	m2					118.80					
	Uje teknologjik	l					4,400.00					
	Zall (granil) lavatrice	m3					17.38					
3.396/1	Mbushje me zhavorr pas mureve	m3	106.0	20								
	Sp+p	op		4.24				0.53	20	0.03		
	Zhavor lumi	m3					114.48					
	Fadrom	op				4.24		0.53	20	0.03		
3.396/1	Mbushje me zhavorr pas mureve	m3	34.0	15								
	Sp+p	op		1.36				0.17	15	0.01		
	Zhavor lumi	m3					36.72					
	Fadrom	op				1.36		0.17	15	0.01		
2.262/3	Shtrese betoni C 12/15	m3	9.0	15								
	Sp+p	op		77.40				9.68	15	0.65		
	Betoni C-12/15 (Me zall)	m3					9.36					
	Vinc kulle 4-6 T me manovrator	op				6.57		0.82	15	0.05		
2.355/b	Veshje fasade me pllaka guri	m2	114.0	15								
	Sp+p	op		1,242.60				155.33	15	10.36		
	Vinc kulle 4-6 T me manovrator	op				34.20		4.28	15.00	0.29		
	Rrasa guri t = 20-30mm (gur dekorativ)	m2					116.28					

	Llac cemento M - 200 (1 : 2)	m3					2.28					
2.231/1	Shtrese asfaltobetoni me zall lavatrice, 3cm, me makineri	m2	746.0	5								
	Sp+p	op		61.17				7.65	5	1.53		
	Autobitumatrice	op				0.75		0.09				
	Rul (kompresor) me vibrim	op				5.22		0.65				
	Asfaltoshtruese	op				5.22		0.65				
	Bitum M-3 (leng)	kg					373.00					
	Asfaltobeton me zalle dhe rere lavatrice	ton					51.47					
2.231/1	Shtrese asfaltobetoni me zall lavatrice, 3cm, me makineri	m2	815.0	5								
	Sp+p	op		66.83				8.35	5	1.67		
	Autobitumatrice	op				0.82		0.10				
	Rul (kompresor) me vibrim	op				5.71		0.71				
	Asfaltoshtruese	op				5.71		0.71				
	Bitum M-3 (leng)	kg					407.50					
	Asfaltobeton me zalle dhe rere lavatrice	ton					56.24					
An1	F.V Parmak Dekorativ (90x90)	cope	299.0	20								
	Sp+p	op		89.70				11.21	20	0.56		
	Parmak Metalik (90x90)	cope					299.00	37.38				
An2	Stola Dekorative	cope	6.0	15								
	Sp+p	op		9.00				1.13	15	0.08		
	Stola Dekorative	cope					6.00	0.75				

Totali I materialeve qe do te transportohen	1860 ton
Afati I punimeve	30 dite
Sasia e transportuar ne dite	60 ton/dite
Rruge kamioni ne dite	6 rruge
Sasia e transportuar per 1 rruge	10 ton
Kamionat qe nevojiten per transportin e 60 ton ne dite	1 kamion 10 ton
Transporti i stolave, parmakeve, derrasa etj.	1 kamioncine 3.5 - 5 ton

Numri i manovratorëve dhe shoferëve të kamionit është përcaktuar nga numri i makinerive që janë të domosdoshme për kryerjen e punimeve, 6 makineri dhe 2 kamionë, si dhe mbështetur në bashkërendimin dhe mbivendosjen e proceseve të punës sipas grafikut të zbatimit të punimeve.

2.4 Ofertuesi duhet të disponojë minimalisht mjetet e mëposhtme për kryerjen e punimeve, me qëllim realizimin e objektit të prokurimit :

Nr	Mjetet	Sasia	
1	Mjet transporti veteshkarkues ≥ 10 ton (kapac. mbajtes)	1 cope	Në pronësi ose me qera
2	Autovinc deri 5 ton	1 cope	Në pronësi ose me qera
3	Mjet transporti veteshkarkues min 3.5 ton (kapac. mbajtes)	1 copë	Në pronësi ose me qera
4	Eskavator	1 copë	Në pronësi ose me qera
5	Betoniere 500 l	1 copë	Në pronësi ose me qera
6	Vibrator thellesie	1 copë	Në pronësi ose me qera
7	Grejder	1 cope	Në pronësi ose me qera
8	Fadromë	1 cope	Në pronësi ose me qera
10	Rrul kompresor per ngjeshje asfalti	1 cope	Në pronësi ose me qera
11	Autobitumatrice	1 cope	Në pronësi ose me qera
12	Asfaltoshtruese	1 cope	Në pronësi ose me qera

Si deshmi per plotesimin e kesaj pike Operatori duhet te paraqese:

- Për mjetet në pronësi që shënohen në regjistra publikë, të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe çertifikatën për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme).
- Për mjetet që nuk shënohen ne regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre: aktet e zhdoganimit ne Republikën e Shqiperisë ose faturat tatimore te blerjes.
- Për te gjitha mjetet e marra me qira, të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati i kontratës.
- Per mjetet e marra me qera qe shenohen ne regjistra publik, duhet te paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe çertifikata për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Kurse per mjetet që nuk shënohen ne regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre, aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.

- Operatori/et ekonomik ofertues duhet te deklaroje qe te gjitha mjetet dhe pajisjet e pershkrhuara, do te jene te angazhuara vetem ne kete kontrate. Mjetet te cilat rezultojne te angazhuara ne kontrata te tjera afati i zbatimit te cilave shtrihet pergjate afatit te kontrates objekt i prokurimit jane shkak skualifikimi. Autoriteti Kontraktor gezon te drejten te verifikojte dhe kontrolloje disponueshmerine e ketyre mjeteve si gjate vleresimit te ofertave ashtu edhe gjate zbatimit te kontrates.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, të paraqitura më sipër.

2.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit për 30 dite kalendarike.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 3.

2.6 Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me :

- Operatori ekonomik duhet të ketë një kontratë me një landfill të vlefshme për depozitimin e mbetjeve inerte.

2.7 Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/certifikuar të cilet duhet të figurojnë në listëpagesën e shoqërisë për tre muajt e fundit, Për secilin duhet të paraqiten: Kontratë individuale të punës dhe Diplomë/certifikate:

- 1 (një) punonjes të disponojë certifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".